



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1621/1 Prot.
2

Tiranë, më 25.10 2022

V E N D I M

Nr. 209 dt. 25.10 2022

**PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI,
PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME "LEKTOR" NË FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË
TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanatit të FSHR me nr. 1621/1 prot., datë 21.10.2022 "Kërkesë për hapje konkursi për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane për vitin 2022- 2023", Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I SHKENCAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE

1. Patologji Specifike (Mod. Reumatologji) "Bachelor" 1 (një) Lektor.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Lektor" në lëndën: Patologji Specifike (Mod. Reumatologji), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor".
 - a. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.

3. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
4. Të ketë veprimtari kërkimore–shkencore dhe botime në disipinën përkatëse.
5. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
6. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.
8. Dëshmi penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Mjekësisë me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
4. Vlerësohen specializime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së mjekësisë.
5. Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e mjekësisë.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon;
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues);
- i) Libreze shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.

VI. Deri në datën 02.11.2022, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda dates 04.11.2022 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.

VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

VIII. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 07.11.2022, për miratim në Rektorat.

IX. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR-së, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* <http://www.ust.edu.al>.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

